

VENDIM
Nr. 110, datë 19.2.2025

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE
TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2025**

(Ndryshuar me VKM nr. 425, datë 23.7.2025; nr. 644, datë 5.11.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2025, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilat lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, është e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, është 75 (shtatëdhjetë e pesë) pozicione të kategorisë së mesme dhe të ulët drejtuese.

3. Pozicionet në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil për nivelin e mesëm drejtues dhe për nivelin e ulët drejtues përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja 1

**POZICIONET NË TË CILAT MUND TË KONKURROJNË EDHE KANDIDATË NGA
JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

I. Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm

1. Jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri;

2. Koordinator në Njësinë e Politikës dhe Agjendës së Reformave drejt BE-së, në Departamentin e Politikës dhe Integritit Evropian, në Kryeministri;

3. Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;

4. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik, në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

5. Koordinator në sektorin (zyrën) e menaxhimit pranë Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm, në Kryeministri, gjithsej, 4 pozicione;

6. Drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

7. Drejtor i Drejtorisë së Granteve, në Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

8. Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, në Drejtorinë e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar, në Ministrinë e Financave;

9. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

10. Shfuqizuar;

11. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjeve Territoriale, në Ministrinë e Brendshme;

12. Drejtor i Drejtorisë së Statistikave, Analizës dhe Raportimeve, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

13. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Përfshirjes Sociale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

14. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

15. Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficiencën e Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

16. Shfuqizuar;

17. Drejtor i Institutit të Transportit;

18. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;

19. Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Projekteve, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;

20. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Sigurimeve Shoqërore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Punësimit, Aftësisimit dhe Sigurimeve Shoqërore, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

21. Drejtor i Drejtorisë së Simulimit dhe Observimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizave Ekonomike, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

22. Drejtor i Drejtorisë së Shitjes së Pronës Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

23. Shfuqizuar.

24. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit të Pronës Shtetërore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.

II. Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm

1. Përgjegjës i Sektorit të Restaurimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Arkivore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;

2. Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;

3. Analist në Sektorin e Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

4. Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

5. Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit;

6. Përgjegjës i Sektorit të Hetimit Administrativ, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit;

7. Drejtor i Qendrës së Mbrojtjes Civile për Qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë me Qendër në Fier, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

8. Përgjegjës i Sektorit të Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe i Statistikave, në Drejtorinë e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

9. Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve Multilaterale, në Drejtorinë e Programeve Ndërkombëtare, në Agjencinë e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

10. Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;

11. Përgjegjës i Sektorit të Analizës, Investigimit, Monitorimit dhe AFCOS, në Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik, në Ministrinë e Financave;

12. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave;

13. Inspektor i parë, në Sektorin e Kontrollit të Individit, në Drejtorinë e Kontrollit të Specializuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

14. Trajner i brendshëm, në Drejtorinë e Trajnimeve, në Qendrën e Trajnimit së Administratës Tatimore dhe Doganore;

15. Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, në Drejtorinë e Administrimit të Regjistrave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme;

16. Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Aktiveve, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Brendshme;

17. Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Juridike, në Drejtorinë Juridike, në Departamentin për Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

18. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kontratave të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

19. Përgjegjës i Sektorit të Financës, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

20. Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Zhvillimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

21. Përgjegjës i Sektorit të Pranimi të Kampionëve dhe Vivariumit, në Departamentin e Menaxhimit të Cilësisë, Pranimi të Kampionëve dhe Vivariumit, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë;

22. Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve, në Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural;

23. Përgjegjës i Sektorit të Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Lushnjë;

24. Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;

25. Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë e Pajisjeve Mjekësore dhe Kozmetikës, në Drejtorinë e Politikave Farmaceutike dhe Pajisjeve Mjekësore, në Drejtorinë e Përgjithshme e Zhvillimit të Shëndetësisë, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

26. Përgjegjës i Sektorit të Optimizimit dhe Pavarësisë Spitalore, në Drejtorinë e Politikave të Shërbimit Spitalor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Shëndetësisë, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

27. *Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit Ligjor, në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;*

28. Përgjegjës i Sektorit për Zbatimin e Iniciativës EITI në Shqipëri, në Sekretariatin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse;

29. Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Koordinimit të Programeve në Mjedis, në Drejtorinë e Ekonomisë Qarkulluese, në Drejtorinë e Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;

30. Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë;

31. Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë;

32. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit, në Drejtorinë e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrimit të Zonave të Mbrojtura, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;

33. *Shfuqizuar;*

34. Përgjegjës i Sektorit të Privatizimit dhe Monitorimit të Shoqërive në Likuidim, në Drejtorinë e Privatizimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

35. Përgjegjës i Sektorit të Fondit Social të Punësimit, në Drejtorinë e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Punëdhënësin, në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive;

36. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;

37. Përgjegjës i Sektorit të Bashkëpunimit për Zhvillim, në Drejtorinë e Diplomacisë Ekonomike, Kulturore dhe Diasporës, në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.